



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT PRISTINA

Në bazë të Rregullores Nr 02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Sherbimin Civil i Ligjit Nr.03/L-149 për Sherbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në bazë Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, Nr.04/2016 të dt.04.11.2016, për Rregullimin e Procedurës së Rekrutimit për Punësimet me Kontrata të quajtura „Marrëveshje për Shërbime të Veçanta,

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

rishpall:

K O N K U R S

Nr. 03/2019

Përkthimi i detyrave të punës

Titulli i pozitës: Zyrtar për Përkthime /gjuha- shqipe dhe serbe dhe anasjelltas

Numri i zyrtarëve që do të pranohen 1

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Nëpunësi mbikëqyrës: Administratori i Gjykatës

Pagesa mujore 490.00 bruto.

Kohëzgjatja e punës (projektit) 6 muaj, me mundësi vazhdimi edhe 4 muaj tjerë.

1. Qëllimi i vendit të punës: Përkthen të gjitha materialet nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, si dhe ofron përkthime gjate seancave gjyqesore në forme konsektive apo simultan.

Detyrat Kryesore:

1. Bën përkthimin dhe pershtatjen e të gjitha materialeve: dosjeve të lëndëve, dekreteve, rregulloreve, ligjeve, komentareve ligjore të ligjeve të aplikueshme në Kosovë, korrespondencë gjyqësore zyrtare, dhe shkresa tjera, me shkrim nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;
2. Përkthen simultan në të gjitha takimet sipas nevojës;
3. Përgatitë raporte mbi punën dhe i raporton eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
4. Kryen edhe detyra tjera për përkthim sipas nevojës.

Shkathtësitë aftësite e kërkuara:

5. Shkathtësi të shkëlqyera gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim në gjuhën shqipe dhe serbe-----E nevojshme
6. Njohuri të mirë të sintaksës dhe morfologjisë për të dy gjuhët ----- E nevojshme
7. Njohja e punës me programet kompjuterike (word,exell)----- E nevojshme
8. Dy (2) vite përvojë pune profesionale----- E nevojshme
9. Njohuri të gjuhës angleze----- E preferuar

Kualifikimet arsimiore dhe profesinale për këtë post:

- Diplomë Universitare - Fakulteti i Filologjisë (Gjuha Shqipe) apo Fakulteti Juridik,Ekonomik ose i ngjashëm dhe minimum 2 vite përvojë pune profesionale, ose
- Diplomë të shkollës të mesme dhe minimum 10 vite përvojë pune profesionale si përkthyesë/e

VREJTJE:

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatët e jashtëm dhe nënpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi sherbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregullore, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil

3. Konkursi është publikuar më dt. 06.02.2019 dhe mbyllet më 08.02.2019

Aplikacionet mund ti merrni dhe ti dorëzoni në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Pallati i Drejtësisë Objekti A- Lagja “Prishtina E Re”-Rr”Nekibe Kelmendi “ pn.

[Shkarko Aplikacionin](#)

- Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11,pragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madhë të kërkesave të pranura vetëm kandidatët e përzgjedhurë në listën e ngushtë do të kontaktohen.

- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurren. Aplikacionit duhet t’i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata e përvojës së punës, certifikata për interpret gjyqësor dhe dy rekomandime.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t’u futur në listën e ngushtë.

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkangjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.